

APLIKIMIN PËR LEJE MJEDISI TË TIPIT B

Emri i Kompanisë: **AVGAS DISTRIBUTION**
Statusi Ligjor : **Shoqeri Aksionare**
Ortakët/ Aksionerët e Kompanisë: **AV GAS DISTRIBUTION 100% pjesemarrje**

(sipas Ekstraktit të lëshuar nga QKR)

Adresa e zyrës qendrore të Kompanisë: **Rruga Vaqarr - Arbane, km 1 Zona kadastrale
3712, nr pasurise 21/38**

Adresa postale e Kompanisë,
nqse ndryshon nga adresa e mësipërme: **Rruga Vaqarr - Arbane, km 1**
Numri i rregjistrimit të Kompanisë(NIPT) **L11409508E**

1.Vendodhja dhe karakteristikat fizike te projektit

Zgjedhja e shoqerise per vendosjen e aktivitetit eshte ne fshatin Vaqarr Komuna Vaqarr, Tirane.



Figura 1.1 - Ne foto satelitore Vendodhja e sheshit te depozitave te shoqerise AV GAS DISTRIBUTION sh.a

Zona e komunes Vaqarr te Tiranës është një zonë bujqësore por në vitet e fundit e përdorur edhe për qëllime tregtare dhe industriale, nga zhvillimet e shumta të biznesit në këtë zonë.

2. Përshkrimi i aktivitetit

Shoqëria "AV GAS DISTRIBUTION" Sh.a ka vendosur depozita gazi me kapacitet 1000 m³ në total. Depozitat për GNL shërbejnë për depozitim dhe me pas mbushjen dhe shpërndarjen e bombulave të gazit GNL. Ndertimi i impiantit është projektuar të ndërtohet në shesh ndertimi kërkendesh (sipas planimetrisë së bashkëngjitur).

Projekti është i ndarë në këto pjesë kryesore:

- Zona e depozimitit të GNL
- Stacioni i pompave dhe kompresoreve të GNL
- Sistemi i tubacioneve për furnizimin e depozitave dhe për mbushjen e autoboteve
- Rezervuarë e ujit të ftohtë me volum 100 m³
- Reparti i mbushjes së bombulave
- Sistemi i furnizimit me ajër
- Sistemi i furnizimit me energji elektrike dhe i tokezimit
- Sistemi i mbrojtjes nga zjarri
- Repartet ndihmëse

Për çështje sigurie territori i impiantit do të rrethohet me një mur rrethues dhe do të bëhet gjelberimi i gjithë sipërfaqes.



Fig.2.1 foto nga muri rrethues dhe gjelberimi

2.1 Zona e depozitimit te GNL

Sipas projektit kjo zone perbehet nga 4 rezervuare cilindrik horizontale me kapacitet 250m^3 secila, presioni maksimal i punes eshte $15\text{kg}/\text{cm}^2$. Aktualisht jane vendosur vetem dy depozita por eshte pergatitur vendi dhe per dy depozita te tjera. Per manovrimin mbi rezervuar ne secilin grup eshte vendosur nje ure lidhese me shkalle metalike.Rezervuare jane te lidhur ne paralel me pompat respektive, njeri per depozitimin e propanit dhe tjetri per mishelen.Depozitat dhe tubacionet jane lyer me boje antindryshk dhe me pas me boje vaji.



Fig. 2.2 Foto nga cisternat e depozitimit te GNL

2.1 Stacioni i pompave dhe kompresoreve te GNL

Stacioni i pompave dhe kompresoreve te GNL perbehet nga:

- Dy elektropompa centrifuge me kapacitet $16 \text{ m}^3/\text{ore}$ N =10kw secila
- Dy elektropompa rrotative Pr1 dhe Pr2 kapacitet $25 \text{ m}^3/\text{ore}$ N =11kw secila
- Dy elektrokompresore Blackmer C1 dhe C2 rrotative Pr1 dhe Pr2 kapacitet $60 \text{ m}^3/\text{ore}$ N =30kw secila

Pompat centrifuge sherbejne per dergimin e GNL ne repartin e mbushjes se bombulave , ndersa ato rrotative per mbushjen e boteve te vegjel. Elektrokompresoret sherbejne per shkarkimin e boteve te propanit dhe mishaes.



Fig.2.3 Foto nga stacioni i pompave dhe kompresoreve.

2.3 Furnizimi i rezervuareve me GNL

Furnizimi i rezervuareve me GNL nga autobotet dhe anasjelltas do të bëhet nga pika e qendrimit të autoboteve. Linja e tubacioneve është ndërtuar me tuba celiku pa tegel me dimensione DN80, DN65 dhe DN40 për presion PN40 të vendosura në bazamente prej betoni me mbështetje specifike për të shmangur ngarkesat nga ndryshimet e temperaturës. Lidhja me autobotin do të bëhet me tubo fleksibel me valvola perkatese, me pince tokëzimi dhe percjelles bakri për mbrojtje për shkarkimet hidrostetike. Për kontrollin e mbushjes dhe nivelin maksimal të lengut janë vendosur nivel matës elektronikë të cilët dërgojnë komandën në sallën e komandës, prej nga drejtohet operacioni i shkarkimit të botit.

2.4 Mbushja e bombulave

Për mbushjen e bombulave janë vendosur dy sisteme:

- Sistemi i mbushjes së bombulave me karusel përbehet nga karuseli me 12 poste, vaska e kontrollit të rrjedhjes, transportieri dhe grupi motor reduktor i transportierit. Mbushja kryhet në mënyrë automatike me një rendiment 600 bombula/ore

- Sistemi i mbushjes me peshore fikse perbehet nga 4 peshore 100kg te pajisur me pince pneumatike me komande manuale, si dhe me valvul pneumatike per GNL qe kontrollohet nga nje sensor i peshes.



Fig.2.4 Foto nga procesi i mbushjes se bombulave.

2.5 Furnizimi me energji dhe ndricimi

Furnizimi me energji elektrike dhe ndricimi behet nepermjet gabines se te transformatorit 60.4kw te vendosur ne objekt. Shperndarja e rrjetit ushqyes te pajisjeve do te behet nga nje panel komandimi. Fuqia e instalimit eshte 170kw nderkohe njekohshmeria ne pune e pajisjeve eshte 60kw. Per mbrojtjet nga shkarkimet elektrostatike bashkimet e tubacioneve jane te tokezuara duke u lidhur midis tyre me kabull bakri $S = 35\text{mm}^2$, pjesa e mbitokes eshte lidhur me token me ane te te njejtit percjelles me shufra tokezimi zingato $L = 1.5\text{ m}$ te lidhura me me rrjetin e tokezimit te depozitave.

Ne raste te nderprerjes se energjise do te perdoret gjenerator me djegie te naftes si lende djegese me fuqi 82.5 KVA ose 66kw.

Mjetet motorike qe do te qarkullojne per kete aktivitet do te jene te kufizuara vetem ne rastet e furnizimit dhe te cisternave dhe transportimit te bombulave. Keto mjete te transportit do te perdorin naften si lende djegese.

2.6 Sistemi i Mbrojtjes nga Zjarri

Per mbrojtjen nga zjarri eshte ndertuar nje sistem i stacionuar i pavarur. Sistemi perbehet nga keto pjese:

- a- Rezervuar uji me kapacitet 100m^3 prej betoni me dimensione $8.7 \times 8 \times 1.5$ m, i cili do te siguroje rezerven e nevojshme te llogaritur te ujit ne rast zjarri. Burimi i ujit do te jete nje pus i hapur ne afersi te rezervuarit. Furnizimi me uje nga pompa e pusit do te behet ne menyre automatike ne funksion te ruajtjes se se nivelit maksimal te rezervuarit.
- b- Elektropompat e ujit dy cope te vendosura ne afersi te rezervuarit me kapacitet $Q1 = 90\text{m}^3/\text{ore}$ dhe $Q2 = 50\text{m}^3/\text{ore}$ qe do sherbejne per furnizimin me uje te sistemit te ftohjes se rezervuareve, si dh ete hudranteve zjarrfikese.
- c- Sistemi i tiubacioneve dhe pajisjeve per ftohjen e rezervuareve te GNL. Ne pjesen e sipërme te trupit te cdo rezervuari eshte montuar nje tub $\varnothing 40\text{mm}$, i pajisur me sprinkler $\frac{1}{2}$ per nebolizimin e ujit te ftohte. Ne perimter te subjektit jane vendosur 4 hidrante UNI40, me nje kasete me hedhes uji te montuar me tub najloni. Ne objekt jane instaluar edhe mjete zjarrfikese me pluhur.

3. VLERESIMI I NDIKIMIT NE MJEDIS

Vleresimi i ndikimit ne mjedis te aktivitetit te shoqerise "AV GAS DISTRIBUTION" sh.a do te zhvillohet vetem per sa i perket zhvillimit te ketij aktivitetit te impiantit te depozitimit dhe tregtimit te GNL.

Mjedisi i ndikuar	Ndikimi	Shpjegim
Pejsazhi	Ndryshim i pejsazhit te zones	Do te kete nje ndryshim te pejsazhit te zones, nga nje zone me karakter bujqesor ne nje aktiviteti industrial, me levizje autobotesh dhe mjetes te tjera ne menyre te vazhdueshme. Por duhet theksuar se zona ka nje te ardhme per zhvillim industrial, keshtu nuk mund ta konsiderojme si ndikim rrenjesor.
Toke	Ngjeshje e tokes	Nuk do te kete asnje ndikim ne strukturen e tokes perreth zones se aktivitetit.
	Erozion i tokes	Nuk do te kete asnje ndikim ne erozionin e tokes perreth zones se aktivitetit. Siperfaqja e zones eshte pothuajse e rrafshet dhe e stabilizuar.
	Ndotje e tokes	Shoqeria gjate aktivitetit te saj nuk do te kete shkarkime te lengeta apo te ngurta ne toke.

		Emisione te mundshme vajra dhe karburante qe mund te emetohen ne menyre aksidentale nga mjetet e transportit.
Uje	Ndotje e ujerave siperfaqesor	Ndotja e mund te shkaktohet vetem ne raste rrjedhesh nga mjetet e transportit dhe nepermjet shiut te pare rrjedh drejt ujerave siperfaqesore.
	Ndotje e ujerave nentokesore	Edhe per ujerat nentokesor vlen i njeiti vleresim si per ujerat siperfaqesor.
Ajer	Emisione gazesh	Emisione te gazit natyror mund te kete ne nivele minimale vetem gjate procesit te mbushjes se bombulave. Kjo ndodh ne pjesen perfundimtare vetem kur shkeputet lidhja midis tubacionit dhe bombules. Kjo do te jete ne nivele te paperfillshme.
	Zhurme,vibrime	Nuk do te kete shkaktim zhurme nga aktiviteti i impiantit. Zhurma e vetme do te jete nga levizja e mjeteve gjate furinizmit te cisternave. Kjo nuk do te kete nje frekuence te shpeshte. Gjithashtu zhurme mund te shkaktohet edhe nga gjeneratori vetem ne rastet e nderprerjes se energjise. Theksohet se nuk ka zona te banuara ne afersi te zones se impiantit.
Mjedisi biologjik	Flora dhe fauna	Flora dhe fauna e zones nuk do te ndikohet nga aktiviteti i impiantit te depozitimit te GNL dhe as nga tregtimi i tij.
Mjedisi human	Shqetesim te banoreve	Nuk ka banesa ne afersi te zones se projektit. Gjithashtu e ardhmja e zones do te jete per zhvillim te aktiviteteve ekonomike industriale.
Ndikimet te tjera te projektit	Ndikimet ne trafik	Zona nuk ka fluks te madh trafik. Aktiviteti mund te ndikojte ne shtimin e trafikut te zones por megjithate ne nivele te pakonsuderueshme.
	Konsumi i energjise	Energjia e perdorur eshte energjia elektrike, dhe vleresohet se nuk ka konsum te larte te energjise. Gjeneratori do te perdoret vetem ne raste nderprje energjie.
	Rreziku i zjarrit dhe incidenteve	GNL eshte mjaft i djegshem dhe nese eshte ne gjendje te lire ne atmoferen mund te digjet lehtesisht vetem nepermjet nje shkendie. Shoqeria ka marre te gjitha masat e sigurise jo vetem te teknologjise qe te mos kete rrjedhje, por edhe te pajisjeve te tjera qe mund te shkaktojne shkendia. Stafi eshte i trajnuar per sigurine ne pune dhe rrezikun nga zjarri.

3.2 Emisionet e gazeta

Nga aktiviteti i impiantit te depozitimit te GNL, i vetmi emision qe mund te konsiderohet i tille eshte ai nga mjetet e transportit.

Levizja e mjeteve te shoqerise eshte ne varesi te fluksit te punes e cila varion shume prandaj eshte e pa mundur te percaktosh levizjen e mjeteve.

Llogaritjet jane bazuar ne *Estimated Emission Factors for Diesel Heavy Duty Vehicles*, table 7.12, tek *Atmospheric Emission Inventory Guidebook*, CORINAIR, 1996

Shkarkimi	NO _x	CH ₂	VOC	CO	N ₂ O	CO ₂	Grimcat
Total g/km	10.9	0.06	2.08	8.71	0.03	800	

Tabela- Faktorët e shkarkimit për kamionat që punojnë me naftë (3.5 - 16 t)

Duke marre ne konsiderate se zona ne studim ndodhet prane rruges se vjeter Tirane - Durres e cila ka nje fluks te konsiderueshem mjetesh te renda. Gjithashtu zona eshte duke u zhvilluar nga ana industriale

3.3 Mbetje te lengeta

Mbetje te lengeta mund ti kemi vetem ne dy momente:

- Ne rastin kur kryhet ftohja nepermjet ujit
- Ne rastin e shiut te pare qe shplan sheshin dhe merr me vete ndotjen siperfaqesore nese ka.

Ne te dy rastet e siperpermendura ndotja vjen vetem nga ndotje siperfaqesore te sheshit te punes qe mund te jene shkaktuar nga mjetet e transportit gjate proceseve te ndryshme. Prandaj rekomandohet qe stafi te kontrolloj ne menyre te vazhdueshme te gjithe territorin e impiantit per ndotje nga hidrokarburet dhe/ose te nje natyre tjeter dhe te marre te gjithe masat e nevojshme per pastrimit. Gjithashtu te kontrollohen dhe te pastrohen vazhdimisht edhe kanalet qe mbledhin ujerat siperfaqesore.

Ndersa ujerat e zeza te tualeteve te larjes se zyrave perfundojne ne grope septike te ndertuar nga vete shoqeria qe me pas terhiqen me autobote cdo 6 muaj.

3.4 Mbetjet e ngurta

Gjate aktivitetit nuk kemi mbetje teknologjike. Mbetjet qe mund te gjenerohen kane karakter urban dhe mblidhen ne kontenitor me logon e subjektit dhe me pas terhiqen nga mjetet e pushtetit vendor.

3.5 Rreziku nga zjarri dhe masat e sigurise

Sic u theksua edhe me lart impianti i depozitimit te gazit ka shkalle te larte rreziku nga zjarri. Per mbrojtjen nga zjarri eshte ndertuar nje sistem i stacionuar i pavarur. Sistemi perbehet nga keto pjese:

a- Rezervuar uji me kapacitet 100m³ prej betoni me dimensione 8.7x8 H1.5 m, i cili do te siguroje rezerven e nevojshme te llogaritur te ujit ne rast zjarri. Burimi i ujit do te jete nje pus i hapur ne afersi te rezervuarit. Furnizimi me uje nga pompa e pusit do te behet ne menyre automatike ne funksion te ruajtjes se se nivelit maksimal te rezervuarit.

b- Elektropompat e ujit dy cope te vendosura ne afersi te rezervuarit me kapacitet Q1 =90m³/ore dhe Q2=50m³/ore qe do sherbejne per furnizimin me uje te sistemit te ftohjes se rezervuareve, si dh ete hudranteve zjarrfikese.

Sistemi i tiubacioneve dhe pajisjeve per ftohjen e rezervuareve te GNL. Ne pjesen e siperme te trupit te cdo rezervuari eshte montuar nje tub ø40mm, i pajisur me sprinkler ½ per nebolizimin e ujit te ftohte. Ne perimenter te subjektit jane vendosur 4 hidrante UNI40, me nje kasete me hedhes uji te montuar me tub najloni.

Ftohja e cisternave kryhet atehere kur presioni i avujve ne cilsterne eshte rritur si rezultat i temperaturave te larte te mjedisit te jashtem.

4. MASAT ZBUTESE TE NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

4.1 - Masat e pergjithshme te propozuara per zbutjen e ndikimeve negative mjedisore

Me qellim qe te parandalohen, shmangen, minimizohen dhe kontrollohen ndikimet negative mjedisore te projektit gjate zhvillimit te aktivitetit te shoqerise AV GAS DISTRIBUTION sh.a duhet qe shoqeria te marre masat e nevojshme.

Lloji i masave per mbrojtjen e mjedisit qe do te merren ndahen ne:

1. teknike
2. organizative

Kuadri i masave teknike dhe organizative

Cfare	Si
Parandalim	<ul style="list-style-type: none">- Instalimi korrekt i impiantit, me standarte bashkohore europiane per depozitimin e GLN- Perzgjedhja dhe trajnim i personelit per menyren e perdorimit te teknologjise dhe sigurine ne pune- Siperfaqja e rrugeve ne terretorin e impiantit duhet te jene te pastruara per te shmangur ngritje pluhurit.- Perdorimi i naftes D1 per kamionet- kontroll periodik i gjendjes teknike te mjeteve te transportit;- Zbatim i rigoroz i sigurimit teknik gjate punes dhe nderprerjes se saj- Vezhgim dhe kualidim i vazhdueshem i te gjithe teknologjise se projektit, saracineska, tubo, valvola, tapa, guarnicione etj;
Kontroll	<ul style="list-style-type: none">- Sigurimi i te gjitha pajisje te nevojshme per riparim, pastrim dhe nderhyrje ne rast emergjencash- kontroll i sheshit te levizjes se mjeteve per mbetje te hidrokarbureve;- Lagie e sheshit te punes dhe rrugeve te levizjes se autoboteve ne rruget e territorit te impiantit,- Levizje e ngadalte e automjeteve ne rruget e brendshme dhe jashte tij- Larje e shpeshte e makinerive dhe kamioneve te punes
	<ul style="list-style-type: none">- Riparim i menjehershem i difekteve dhe avarive teknologjike

Nderhyrje	<ul style="list-style-type: none"> - Aktivizim i menjehershem i stafit dhe mjeteve ne rast emetimesh dhe derdhesh te pa parashikuara sipas procesit teknologjik. - Pastrim i menjehershem i derdhjeve aksidentale - Njoftim i menjehershem i autoriteteve dhe njesive te specializuara ne rast emergjencash (zjarrfikes, autoambluanca)
Administrim	<ul style="list-style-type: none"> - Perdorimi dhe ruajtja me pergjegjesi i te gjitha infrastruktures dhe makinave sipas skemes dhe rregullave teknologjike. - ndarje e pergjegjise dhe adresim i sakte per ceshtje te sigurise nga zjarri dhe menytrat e veprimit.

4.2 Masat per mbrojtjen e ajrit nga makinerite e transportit

Nr.	Ndikimi	Masat zbutese
1	Pluhura dhe gaze te shkarkuara gjate fazes se transportit	Mjetet e transportit duhet te levizin me shpejtesi te ulet gjate transportit si dhe mjetet duhet te pastrohen vazhdimisht. Nevojitet te kontrollohet vazhdimisht gjendja e tyre teknike, dhe te kryen serviset periodike te nderrimit te filtrave. Rruget e brendshme duhet te jene te shtruara me asfalt.
2	Emetim zhurmash, vibracioni dhe aromash	Duhet te kontrollohen vazhdimisht pajisjet dhe impiantet per zhurmen e shkaktuar. Edhe per kete ndikim duhet te shkurtohet ne maksimum koha e mbajtjes ndezur te motorave te mjeteve;

4.3 Menaxhimi i mbetjeve ngurta

Administrata dhe punonjesit e impiantit te GNL do ti kushtojne vemendje te vecante edhe ketij aspekti per te parandaluar ndotjen ne mjedis nga perhapja e mbetjeve te ngurta te gjeneruara. Vendi ku duhet te ruhen mbetjet aballazhe te lendeve te para te perdorura duhet te jete i rrethuar me bordura te ngritura. Pas grumbullimit keto mbetje do te dergohet tek per ne fushegrumbullimin e mbetjeve urbane te percaktuara nga pushteti vendor.

4.4 Menaxhimi i mbetjeve te lengta

Per menaxhimin e shkarkimeve te lengeta te gjeneruara nga ujerat e shiut dhe ftohja e impiantit nevojiten disa vaska dekantimi per uljen e pezullive dhe nje trajtim i thjeshte fiziko-kimik per asgjesimin e elementeve kimik .

Ndersa ujerat e zeza te tualeteve te larjes se zyrave perfundojne ne grope septike te ndertuar nga vete shoqeria qe do te terhiqen me autobot cdo 6 muaj

4.5 Menaxhimi i mbejteve te gazta

Per kete shoqeria do te kryej kontrollin periodik te shkarkimeve te mjeteve te transportit qe perdor.

4.6 Menaxhimi i rrezikut ndaj zjarret

Te hartohet nje plan per perballimin e emergjave ku te percaktohen detyrat dhe hapat e punes se gjithe stafit. Te trajnohet stafi per implementimin e tij.

4.7 Programi i monitorimit dhe elementet e tij

Ne pergatitjen e programit te monitorimit specialistet kane marre ne konsiderate mundesine per te realizuar nje monitorim realist te elementeve me ndikim ne mjedis. Persa me siper eshte menduar qe te perzgjidhen per tu monitoruar nga laboratore te nenkontraktuar nga vete shoqeria ata elemente qe realisht mund te indentifikohen, maten, rregjistrohen dhe komunikohen ne organet e administrimit te mjedisit (AKM,ARM, Bashki etj). Te dhenat cilesore, sipas tabelës do te hidhen ne nje regjister qe administrohet nga vet kompania dhe do te dorezohen ne ARM e Qarkut sa here ju kerkohet, sipas procedurave ligjore dhe rregulloreve.

Sistemi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe plani i perballimit te tij

Per mbrojtjen nga zjarri eshte ndertuar nje sistem i stacionuar i pavarur. Sistemi perbehet nga keto pjese:

- a- Rezervuar uji me kapacitet 100m^3 prej betoni me dimensione $8.7 \times 8 \times 1.5$ m, i cili do te siguroje rezerven e nevojshme te llogaritur te ujit ne rast zjarri. Burimi i ujit do te jete nje pus i hapur ne afersi te rezervuarit. Furnizimi me uje nga pompa e pusit do te behet ne menyre automatike ne funksion te ruajtjes se se nivelit maksimal te rezervuarit.
- b- Elektropompat e ujit dy cope te vendosura ne afersi te rezervuarit me kapacitet $Q_1 = 90\text{m}^3/\text{ore}$ dhe $Q_2 = 50\text{m}^3/\text{ore}$ qe do sherbejne per furnizimin me uje te sistemit te ftohjes se rezervuareve, si dh ete hudranteve zjarrfikese.
- c- Sistemi i tiubacioneve dhe pajisjeve per ftohjen e rezervuareve te GNL. Ne pjesen e sipërme te trupit te cdo rezervuari eshte montuar nje tub $\varnothing 40\text{mm}$, i pajisur me sprinkler $\frac{1}{2}$ per nebolizimin e ujit te ftohte. Ne perimeteer te subjektit jane vendosur 4 hidrante UNI40, me nje kasete me hedhes uji te montuar me tub najloni. Ne objekt jane instaluar edhe mjete zjarrfikese me pluhur.

Egzistojne pese (5) kategori zjarri qe ndihmojne jo vetem per dallimin e llojit te zjarrit por edhe dallimin e llojit te agjenteve ose materialeve qe nevoiten per ta shuar ose per ta mbajtur nen kontroll .

Klasi A Zjarre qe krijohen me material- zakonisht organike, si :druri, kartoni, letra, qilima dhe perde, te cilat djegja behet zakonisht me thengjill

Klasi B Zjarre qe krijohen me lengje si : nafta, parafina, diluenti, verniqe, bojra dhe lende qe mund te shkrihen si qirinj (dyll).


Klasi C Zjarre qe krijohen nga gazrat si LPG (psh. Butan, propan) ose zjarre me gaz natyror.

Klasi D Zjarre qe krijohen nga djegia e metaleve ne forme ristelash apo pluhuri si : natriumi, litiumi, magneziumi dhe alumini.

Klasi E Zjarre qe perfshijne paisje elektrike. Ky lloj zjarri mund te shkatohet psh. nga makineri qe kane bere qark te shkurter ose kablllo elektrike te mbingarkuara

Zjarri nuk respekton askend dhe asgje. Ai vret, shkaterron, gjymton dhe mund ti Jere njerezit pa pune ne qofte se shkaterrrohet vendi i punes. Per keto arsye punonjesi i sigurise duhet te kuptoje qarte shkaqet e zjarrit dhe menytrat e parandalimit. Ai duhet te dije si te parandaloje nisjen e zjarreve dhe si te veproje kur ka nisur nje zjarr. Zjarri qe te egzistoje, ka nevoje per tre elemente per te egzistuar. Ne qofte se i hiqet njeri prej tyre, nuk do te kete me zjarr. Zjarri mund te parandalohet duke u siguruar qe keta tre elemente nuk bashkohen ne menyre te pakontrolluar.

Tre elementet e zjarrit



Hiqni nje element dhe zjarri fiket

Oksigjeni

21 % e ajri t qe thithim eshte oksigjen .Oksigjeni mund te hiqet duke mbyllur dyert dhe dritaret, duke mbyllur sistemet e ventilimit dhe kondicionimit.

Karburanti

cdo gje digjet :

Hiqni ose nderprisni burimin e karburantit - par vetem neqofte se nuk ka rrezik

Burimi i nxehtesise

Prerja e energjise ne nje zjarr elektrik o se fikja e makinerise qe ka krijuar burimin e nxehtesise.

Largojeni nxehtesine duke e ftohur me uje ose me fiksin e duhur per ate lloj zjarri.

Avancimi i zjarrit

Punanjesi i Sigurise duhet te kuptoje qe zjarret avancajne shpejt. Askush nuk duhet te rrije per nje kahe te gjate , pasi zjarri te kete filluar te shtohet. Zjarri mund te dale shpejt nga kantralli dhe mund te behet i rrezikshem per jeten e njerezve .

Punanjesi i Sigurise duhet:

Duhet te dije gjithmone se cilin lloj fikesi duhet te perdore per llojet e ndryshme te zjarrit

- Te lere gjithnje vend per dalje dhe te sigurohet qe nuk eshte zene
- Te jete gjithmone ne dijeni te venddodhjes se fikseve te zjarrit
- Te dije si te perdore fikeset e zjarrit
- Te njohe kadet me ngjyra
- Te mos pravoje kurre te fike zjarrin ne qoftese ka rrezik

Zbulimi i zjarrit

Punanjesi i Sigurise duhet te kete parasysh sekuencen e meposhtme kur zbulon nje zjarr:

- Gjej
- Lajmero
- Kufizo
- Evaku/ Fik

Ne qofte se Punonjes i Sigurise zbulon nje zjarr, ai duhet te ndjeke proceduren e meposhtme:

- Ti bjere alarmit
- Te lajmerojezjarrfiksit ose sherbimet e tjer te emergjences q nevojiten
- Te lajmeroje Pergj. e Sherbimit
- Te ndihmoje ne evakuimin e njerezveve , nese eshte i nevojshem.
- Te ndihmoje ne evakuimin e njerezveve, nese eshte i nevojshem

Ne qofte se zjarri eshte i vogel dhe nuk ka rrezik :

- Te mundohet ta shuaje
- Kurr e te mos e vere vehten ne rrezik
- Te lere gjithnje nje dalje

Ne situata te tjera, kur nuk ka rrezik :

- Te mundohet t'i nderprese oksigjenin - zjarrit, duke mbyllur dyert dhe dritaret
- Te mundohet te nderprese karburantin - zjarrit, duke hequr materialet e djegeshme qe kane prane.

Kur ka nevoje per evakuim

- Ti shtyje njerezit te perdorin daljet e emergjences, kur eshte e mundur
- Ti beje njerezit te drejtohen shpejt drejt pikes se grumbullimit
- Te ruajene gjakftohtesine
- Te mos lejoje njeri te kthehet per te marre gjerat personale

Te pika e grumbullimit, duhet te beje apelin dhe te gjenden te gjithe personat, perfshire dhe vizitoret. Ne qofte se eshte e mundur , te takohet me zjarrfiksesit dhe t'i ndihmoje atje ku nuk ka rrezik

Punonjes i i Sigurise duhet tu jape zjarrfikeseve informacionin e meposhtem:

- Personat qe mungojne
- Vendodhjen e zjarrit
- Rreziqet e vecanta
- Vendodhjen e hidranteve dhe tubave kryesore
- Vendodhjen e stacioneve te pompimit
- Rruget e hyrjes dhe te evakuimit
- Vendodhjen e paneleve te zjarrit dhe alarmit
- Llojin e zjarrit

Mbani shenime te plota per ngjarjen :

- Oren: oren e zbulimit; oren e thirjes se zjarrfikeseve; ardhjen e zjarrfikeseve;
- Emrat : Emrat e personelit kryesor te emergjencave, emrat e deshmitareve.

- Te evidentohet dhe shkaku i mundshem i renies se zjarrit, vendodhjen e saktë, demet dhe veprimet e ndermara.

Pajisjet per fikjen e zjarrit

Fikesja e zjarrit

"AV GAS Distribution" ka paisje te mjaftueshme per fikjen e zjarrit. Sherbimi zjarrfikës vendos se cfare paisjesh duhen te perdoren dhe ne cfare sasie. Punonjesi i Sigurise duhet te dije vendosjen e te gjitha pikave zjarrfikese, llojet e zjarrfikeseve te dores, cfare fikin dhe menyren e perdorimit.

Gjate patrullimit, Punonjesi i Sigurise duhet te kontrolloje fikset e zjarrit per tu siguruar qe ndodhen ne vendin e duhur, qe nuk jane zbratur ose demtuar, qe siguresat jane ne pozicionin e duhur dhe te raportojne cdo defekt tek Pergj. i Sherbimit.

Fikset e zjarrit zakonisht kane nje ose dy kode me ngjyra. Ne qofte se jane te reja - jane te kuqe me doreza me ngjyre ose me mase ose me ndonje rrip me ngjyre mbi cilindër. Ne qofte se jane te vjetra, i gjithë cilindri do te ketë ngjyren e kodit tregues.

Shpjegimi i Kodeve

UJE- E KUQE

Fikset me Uje (Hidrantet)

Uji heq nxehtesine dhe ftoh materiaLin qe digjet. Perdoret zakonisht per lende te ngurta si druri dhe letra. Kur kemi te bejme me zjarr elektrik, uji mund te percoje korrentin tek ju, kurse zjarret e dhjamrave ose vajrave perkeqesohen kur i hidhni uje sepse mund te shperthejne kur preken nga uji.

Mos perdorni uje ne keto lloje zjarresh

Pluhur i bardhe -BLU

Fikeset me Pluhur

Pluhur i prish reaksionin kimik te zjarrit. Fikset me pluhur duhet te perdoret vetem si mundesi e fundit ne zjarret elektrike. Gjate perdorimit keto lloje fiksesh lene mbetje qe eshte shume e veshtire te hiqet nga paisjet elektrike.

Drejtojeni rrymen tek flaket duke e Jevizur dhe lereni pluhurin te bjere ne mes te flakeve. Prisni deri sa te pastrohet ajri dhe ne qofte se shihni prape flake hidhni perseri pluhur. Duhet te kihet parasysh qe pluhuri i thate ftoh shume pak dhe ka mundesi qe te rinise zjarrin. Fiksi me pluhur te bardhe nuk perdoret per zjarre dhjamrash ose zjarre gatimi.

AFFF dhe shkuma - Krem

Shkuma Ujore Film Formuese (AFFF) dhe fikset me shkume e mbysin zjarrin me nje film shkume te hedhur ne siperfaqe te lengjeve qe digjen.

Ne qofte se lengu ndodhet ne ene, drejtoni fiksen tek ana e brendshme e enes ose tek nje siperfaqe aty prone siper lengut qe digjet. Per zjarre qe nuk jane nen kontroll, drejtojeni fiksen tek baza e flakeve dhe levizeni ate ne zonen e zjarrit duke filluar nga zona me prane jush dhe duke e mbuluar te gjithë zonen e prekur. Mos e perdorni fiksen me shkume ne zjarre yndyrnash ose gatimi

Dioksid Karboni - E Zeze

Fiksi me dioksidi karbonit (CO2) funksionon duke leshuar gaz te lengeshem, i cili mbyty f/aket duke hequr oksigjenin nga ajri.

Perdorimi Drejtohet tyta e fikses tek baza e flakeve dhe vendos derdhjen pergjate gjithë zones se flakeve. Mos e mbani doren tek tyta, pasi ftohet shume. Mos e perdorni fiksen me CO2 per zjarre yndyrnash ose gatimi

Kimikat i lengeshem - I Verdhe

Keto fikse jane ideate per zjarret me vajra gatimi dhe yndyrna si : vaj ulliri; vaj luledielli; vaj misri dhe gjalp. Ky solucion i fik f laket shpejt, ftoh siperfaqen dhe ben reaksion kimik duke formuar nje solucion si sapun , duke izoluar siperfaqen dhe parandaluar rindezjen.

Ne ambjentet e AV GAS Distribution jane instaluar paisje qe mund te perdoren automatikisht ose manualisht ne rast zjarri.

Keto jane :

Sperkatesit

Sperkatesit jane instaluar brenda ndertesave dhe sperkasin me uje nje zone qe zgjidhet nga sensoret. Jane te lidhur me sistemin e alarmit ose aktivizohen manualisht.

Tubat e thate

Tubat e thate jane tuba te cilet perdoren nga zjarrfiksit per te lidhur tubat dhe per te transportuar ujin ne pjese te objektit

Daljet e Shkumes

Daljet e shkumes jane tuba te medhenj te pa mbyllur te cilat dalin ne nje zone me rreziqe specifike

(sic jane Zonat me Kontaktim te Kufizuar - ZKK)

Perbledhje detyrash te Punonjesit te Sigurise

Punonjesi i Sigurise duhet :

- Te dije te gjitha pikat e zjarrit dhe paisjet qe ndodhen ne te
- Te kete njohuri te mjaftueshme per te perdorur zjarrfiksin e duhur per fikjen e zjarrit
- Nuk duhet kurre te mundohet te fike nje zjarr qe mund te shkaktoje rrezik
- Kur te zbuloje zjarr , duhet ti bjere alarmit dhe te informoje zjarrfiksit dhe Pergjegjesin e Sherbimit
- Duhet te mbaje mend qe Punonjesit e Sigurise duhet te takohen me zjarrfiksesit , nese i therrasin, dhe ti japin ndihmen e nevojshme.
- Te mbaje shenimet e duhura ne bllok dhe te perfshije informacionin e duhur, oren, emrat, dhe cdo informacion tjeter qe mund ti nevojitet per raportime te mevonshme.
- Nuk duhet te nenvleftesoje kurre shpejtesine me te cilen zjarri mund te perhapet, te dale jashte kontrolli, te sakatoje , vrase ose shkaterroje.

KONKLuzion

ZJARRI ESHTË I RREZIKSHEM, I PA PARASHIKUESHEM DHE MUND TE VRASE.

